



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201402518/10

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Rekomandohet dhënia e pagës për lejen e pakryer ushtarakes të dalë në rezervë Gj. S.*

Drejtuar: **Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura**
Gjeneralmajor Jeronim BAZO

TIRANË

I nderuar Z. Bazo,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetësja Gj. S., ushtarake e dalë në rezervë, e cila pretendon se nuk i është paguar koha e pakryer e lejes vjetore. Në fillim të vitit 2014 kjo shtetase ka depozituar në komandë kërkesën e saj për planifikimin e lejes vjetore për 45 ditë. Nga 45 ditë leje vjetore të kërkuara, komanda ka miratuar vetëm 11 ditë për arsye të riorganizmit të KDS dhe volumit të punës. Në datën 13.10.2014 Gj. S. është njoftuar për nxjerrjen e saj në rezervë. Pas daljes në rezervë, ankuesja ka kërkuar të paguhet për kohën e pakryer të lejes vjetore, por kjo kërkesë është refuzuar.

Për këtë rast i jemi drejtuar me një kërkesë për shpjegime Shtabit të Përgjithshëm të FA. Në përgjigjen ardhur me shkresën Nr.4722/3 Prot., datë 16.06.2015 na referohet legjislacioni ku bazohet refuzimi i kërkesës së shtetases Gj. S. i për tu paguar për kohën e pa kryer të lejes vjetore. Legjislacioni i referuar është si më poshtë vijon:

1. Neni 92, pika 3 i Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i RSH*" ku përcaktohet se: "*Kur nëpunësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës*".
2. Neni 32, pika 2 i Ligjit Nr.9210, datë 23.03.2004 "*Për Statusin e Ushtarakut të FA të RSH*" ku përcaktohet se: "*Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar për oficerët dhe nënoficerët aktivë të FA është 45 ditë kalendarike*".
3. Pika 3 e VKM Nr. 511, datë 24.10.2002 "*Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore*", i ndryshuar sipas VKM Nr.463, datë 16.05.2011 ku përcaktohet se: "*Pushimet vjetore nuk*

mund të kompesohen me pagesë, përveç rastit kur është zgjidhur marrëdhënia e punës. Çdo marrëveshje që parashikon heqjen dorë nga e drejta e pushimit vjetor, kundrejt pagesës, do të jetë e pavlefshme”.

4. Shtojca 3 e Urdhërit Nr. 1446, datë 06.10.2014 “*Politikat dhe procedurat standart të emërimit të personelit në FA*” të Ministrit të Mbrojtjes, nuk parashikon kompesimin e pushimit vjetor.

Nga analiza në tërësi e legjislacionit në fuqi rezulton se, kërkesa e efektivitetit të FA Gj. S. për tu paguar për kohën e pakryer të lejes vjetore është e bazuar në ligj. Neni 32/3 i Ligjit Nr.9210, datë 23.03.2004 “*Për Statusin e Ushtarikut të FA të RSH*” parashikon se: “*Kur ushtaraku, për shkak të detyrës, nuk e kryen lejen e pagueshme vjetore, paga për lejen e pakryer i jepet në pagesën e dytë të Muajit Mars të vitit pasardhës*”. Ish Kaptere Gj. S. ka kërkuar në vitin 2014 ti jepet leje vjetore për 45 ditë, por për nevoja të punës ajo ka kryer vetëm 11 ditë leje.

Neni 92/3 i Kodit të Punës ka të bëjë me kohëzgjatjen e pushimit vjetor që i takon një të punësuar në varësi me kohëzgjatjen e tij në punë dhe jo me faktin nëse ai duhet të paguhet ose jo për kohën e pa kryer të lejes vjetore.

Neni 32/2 i Ligjit “*Për Statusin e Ushtarikut të FA në RSH*” përcakton kohëzgjatjen e pushimit vjetor që i takon ushtarakut të FA dhe që është 45 ditë kalendarike. Pika 2 e nenit 32 nuk bën përcaktime nëse ushtaraku duhet të paguhet ose jo për kohën e pa kryer të lejes vjetore.

VKM Nr. 511, datë 24.10.2002, i ndryshuar, është akt nënligjor dhe në hierarkinë e akteve normative vjen pas ligjit. Për të vlerësuar nëse ushtarakut i takon ose jo të paguhet për kohën e pakryer të lejes vjetore fillimisht duhet ti referohemi Ligjit “*Për Statusin e Ushtarikut të FA në RSH*”. Siç është shpjeguar edhe më lart, neni 32/3 i këtij ligji ia njuh këtë të drejtë ushtarakëve. Edhe nëse për këtë rast do të zbatohet pika 3 e VKM Nr. 511, datë 24.10.2002, i ndryshuar, Kaptere Gj. S. duhet të paguhej për kohën e pa kryer të lejes vjetore pasi marrëdhënia e punës është zgjidhur dhe pika 3 përcakton se, pushimet vjetore mund të kompesohen me pagesë vetëm në rastin kur është zgjidhur marrëdhënia e punës.

Urdhëri Nr. 1446, datë 06.10.2014 “*Politikat dhe procedurat standart të emërimit të personelit në FA*” të Ministrit të Mbrojtjes është një akt nënligjor dhe aktet nënligjore dalin në bazë dhe për zbatim të ligjit (neni 118/1 i Kushtetutës). Nëse ligji parashikon se ushtaraku duhet të paguhet për kohën e pa kryer të lejes vjetore dhe urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes i dalë në zbatim të këtij ligji nuk e parashikon këtë të drejtë, atëherë zbatohet norma e parashikuar në ligj.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*” si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*” (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*”

JU REKOMANDOJMË:

Dhënien e pagës për lejen e pakryer ushtarakes të dalë në rezervë Gj.
S.

Në bazë të nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

**Në Mungesë
dhe me Porosi**

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI